



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

# Raport VJETOR 2014



RAPORT  
I  
VEPRIMTARIVE SHKENCORE  
DHE  
BOTIMEVE PËR VITIN 2014

Përgatitur nga:  
Kryesia e Akademisë së Shkencave e Shqipërisë  
Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike  
Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike

Nën drejtimin e:  
Akademik Vasil S. Tole

Redaktore:  
Albana Velianj

Kompjuterizimi  
Enkelejda Misha

Adresa:  
Akademia e Shkencave e Shqipërisë  
Sheshi Fan S. Noli, Tirana, Albania  
Tel: 00355 4 2259657  
Tel/Fax: 00355 4 2227476

<b>HYRJE</b>	5
<b>I. RAPORT I VEPRIMTARIVE 2014</b>	7
• <i>Konferenca Shkencore.</i>	8
• <i>Botimet shkencore.</i>	12
• <i>Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.</i>	17
• <i>Veprimtari shkencore në Akademinë e Shkencave.</i>	22
<b>II. PËRPARËSI 2015</b>	27
• <i>Strukturimi i komunitetit shkencor.</i>	
• <i>Ndërtimi i infrastrukturës për shkencën.</i>	
• <i>Ndërtimi i komunikimit mes shkencës dhe politikës.</i>	
• <i>Sigurimi i përparësisë së shkencës dhe lidhjes së saj me ekonominë dhe komunitetin që orienton zhvillimin drejt një shoqërie të bazuar në dije e shkencë.</i>	
• <i>Sigurimi i burimeve të mjaftueshme që i mundësojnë shkencës të funksionojë, të ndërtojë kapacitete dhe të realizojë produktivitetin e pritshëm.</i>	
• <i>Përmirësimi i cilësisë së kërkimit dhe produktit shkencor.</i>	
<b>III. KALENDARI I AKTIVITETEVE TË PROPOZUARA PËR VITIN 2015</b>	28
<b>IV. BUXHETI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE TABELA E BUXHETIT TË ASH-SË NDËR VITE</b>	29
<b>V. SHTOJÇË: VEPRIMTARITË SHKENCORE TË AKADEMIKËVE</b>	30



# HYRJE

Misioni dhe veprimtaria e Akademisë së Shkencave orientohet dhe organizohet në zbatim të Kushtetutës, legjisllacionit në fuqi, programit të Këshillit të Ministrave në fushën e kërkimit shkencor, marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Akademia e Shkencave dhe Statutit të ASH. Si institucioni shkencor më i rëndësishëm në vend, ajo mbështet dhe u paraprin nevojave aktuale dhe të perspektivës për zhvillimin dhe integrimin e vendit, përmes përfshirjes në iniciativa të reja në fushën e kërkimit shkencor, inovacionit dhe arsimit; bashkëpunimit me institucionet kërkimore dhe ato të ILA, të ekselencës shkencore; duke dhënë zgjidhje për shumë çështje thelbësore, të lidhura me zhvillimin e vendit; duke ui ofruar institucioneve të qeverisjes këshillim dhe ekspertizë në realizimin e detyrave të kërkimit e zhvillimit në të gjitha fushat etj.

Aktualisht, bazuar në Programin e Qeverisë 2013-2017, në kapitullin “Kërkimi shkencor i rigjeneruar”, përcaktohet si detyrë imediate: *“...mbështetja e Akademisë së Shkencave për t’u kthyer në forcë shtytëse të veprimtarisë kërkimore e shkencore në vend dhe përfaqësuese e denjë e komunitetit shkencor si dhe objektivat:...mbështetja e kërkimit shkencor dhe progresit shkencor si paraprijës të zhvillimit të qëndrueshëm shoqëror, ekonomik e kulturor dhe si kusht për integrimet europiane përmes arritjes së standardeve bashkëkohore ; krijimin e Fondit Kombëtar për Shkencën si burim i financimit të qëndrueshëm të kërkimit shkencor përmes zbatimit të projekteve, rritjen e autonomisë; garantimin e sinergjisë midis zhvillimit të shkencës dhe arsimit, sigurimin e pavarësisë së punës kërkimore, vendosjen e një sistemi kualifikimi bashkëkohor me rregulla e kërkesa të larta për të gjithë aktorët e sistemit, për ngritjen e përgjithshme të nivelit të mendimit shkencor dhe shmangien e mediokritetit.”*

Pra, në këtë kuadër të reformave që ka ndërmarrë Këshilli i Ministrave për arsimin e lartë, si dhe për kërkimin shkencor, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, si një institucion elitar shkencor me vlerë kombëtare, do të rivlerësohet duke rritur kapacitetet e veta në strukturën e kërkimit shkencor në Shqipëri, tashmë kur parashikohet që ajo të rimarrë në strukturën e saj institutet dhe qendrat shkencore dhe duke i riformatuar ato në përputhje me strategjitë kombëtare të kërkim zhvillimit.

**Akademia e Shkencave e Shqipërisë, gjatë vitit 2014 ka synuar realizimin e funksioneve të saj në disa drejtime përparësore, nëpërmjet zhvillimit të veprimtarive dinamike, të cilat duke iu referuar krahasimit të treguesve të arritur (që lidhen me aktivitetin kërkimor bazë: të zbatuar apo eksperimental, fushat e kërkimit, burimet njerëzore, shpenzimet), evidentojnë arritje në përputhje me objektivat që ishin planifikuar të realizoheshin. Treguesit e mëposhtëm pasqyrojnë rezultatet që ka arritur ASHSH gjatë vitit 2014. Treguesit ekonomikë të ASHSH gjatë vitit 2014, rezultojnë si më poshtë:**

Fig. 1. Realizimi i buxhetit sipas zërave




Fig. 2. Realizimi Plan - Fakt





Fig. 3. Realizimi i krahasuar i buxhetit



# I. RAPORT I VEPRIMTARIVE 2014

Stafi akademik sot përbëhet nga 24-"Akademikë", 2-"Akademikë të përhershëm", 11-"Akademikë të asociuar", të cilët sipas fushave të kërkimit, zhvillojnë veprimtaritë në seksione. Gjatë vitit 2014, **Seksioni i shkencave shoqërore e albanologjike** ka patur 15 anëtarë dhe **Seksioni i shkencave natyrore e teknike**, 22 anëtarë.

- **Seksioni i shkencave shoqërore e albanologjike:**

Anëtarët e seksionit gjatë vitit 2014 kanë realizuar:

- 10 projekte shkencore;
- 18 konferenca shkencore, simpoziume etj.;
- 13 monografi dhe botime, brenda dhe jashtë vendit;
- 31 artikuj e studime në revista shkencore (17 brenda e 14 jashtë vendit);
- 59 pjesëmarrje në konferenca shkencore (21 jashtë dhe 38 brenda vendit);
- pjesëmarrje në procesin e mësimdhënies e të gjithë "Akademikëve" dhe "Akademikëve të asociuar" të Seksionit të shkencave shoqërore dhe albanologjike.

- **Seksioni i shkencave natyrore dhe teknike:**

Anëtarët e seksionit gjatë vitit 2014 kanë realizuar:

- **30** projekte shkencore, nga të cilat: **3** projekte në kuadër të Programeve Kombëtare për Kërkim e Zhvillim – AKTI dhe Protokollat e Bashkëpunimit Dypalësh; **1** projekt nga Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës; **25** projekte në kuadër të programeve të BE (FP-7 dhe të organizmave të tjerë ndërkombëtarë); **1** projekt të Akademisë së Shkencave dhe institucioneve të tjera në vend.
- **16** konferenca shkencore, simpoziume etj. (**8** ndërkombëtare dhe **8** kombëtare);
- **12** monografi (10 brenda dhe **2** jashtë vendit);
- **125** artikuj në revista shkencore (**10** brenda dhe **115** jashtë vendit);
- **110** pjesëmarrje në konferenca shkencore (**17** brenda dhe **93** jashtë vendit);
- pjesëmarrje në procesin e mësimdhënies e të gjithë "Akademikëve"

dhe "Akademikëve të asociuar" të Seksionit të shkencave natyrore e teknike.

### **1.1.KONFERENCA SHKENCORE, REFERIME AKADEMIKE, SIMPOZIUME ETJ.**

- **Konferenca shkencore ndërkombëtare**  
**"70-Vjetori i Çlirimit – ngjarje e rëndësishme kombëtare"**  
**(27 nëntor 2014)**

Konferenca shënoi veprimtarinë më të rëndësishme shkencore kushtuar kësaj ngjarjeje me rëndësi të veçantë historike në jetën e popullit dhe të kombit shqiptar, në dritën e dokumenteve të reja të arkivave vendëse dhe të huaja. Konferenca pati si synim dhe arriti të trajtojë me objektivitet shkencor çështje thelbësore të debatit historik për karakterin e luftës, rolin e forcave të ndryshme politike në të, ndryshimet që solli lufta si katalizator social në gjirin e shoqërisë shqiptare dhe produktin e këtij ndryshimi–përballjen e rezistencës aktive me kolaboracionizmin, marrëdhëniet e tyre me fuqitë e mëdha aleate dhe antifashizmin si vlerë universale e shekullit që shkoi dhe alternativë e perspektivës historike të kombit. Në konferencë morën pjesë historianë nga Shqipëria, Kosova, SHBA, Rusia dhe u mbajtën 10 referate që trajtuan nga aspekte të ndryshme historinë e luftës.

- **Konferenca shkencore ndërkombëtare**  
**"Jeronim de Rada (1814-2014)"**

Kjo konferencë u zhvillua nën shenjë të 200-vjetorit të lindjes së poetit të madh arbëresh Jeronim de Rada, në bashkëpunim me Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, me pjesëmarrje të gjerë studiuesish nga të gjitha universitetet kryesore të vendit, nga Italia, Greqia, Kosova e Maqedonia etj. Konferenca bëri një sintezë të rezultateve të arritura në studimet deradiane, me një përpjekje të re për të trajtuar në dritën e metodave moderne aspekte të ndryshme të veprës së De Radës si poet, si folklorist, filolog, publicist, atdhetar dhe veprimtar i lëvizjeve shoqërore e politike edhe në Italinë e kohës, duke kompletuar kështu figurën poliedrike të këtij kolosi të kulturës shqiptare, i cili, ndër të parët hapi rrugën e një letërsie të re, romantike për nga fryma, moderne për nga forma, mjetet e shprehjes dhe strukturat e ligjëritimit poetik. Pjesë e programit të konferencës ishte paraqitja e botimit në 6 vëllime të veprës së De Radës, përparë nga akad. F. Altimari e prof. M. Mandala dhe e shoqëruar me një analizë të kritereve shkencore të këtij botimi nga akad. Jorgo Bullo.

- **Konferenca shkencore ndërkombëtare:**  
**"Parandalimi i kancerit: sfida dhe mundësi" (6 qershor 2014)**

Konferenca u organizua nga Akademia e Shkencave, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë së Shqipërisë, Organizatën Botërore të Shëndetësisë, Universitetin Mjekësor të Tiranës



dhe Institutin e Shëndetit Publik. Qëllimi i konferencës ishte evidentimi dhe mënjanimi i faktorëve specifikë të rrezikut të sëmundjes kanceroze në vendin tonë dhe përpilimi i një platforme për parandalimin dhe diagnozën e hershme të kancerit. Referatet u mbajtën nga specialistë të ftuar nga OBSH, specialistët më të shquar nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Në konferencë u referua mbi politikat për parandalimin dhe diagnozën e hershme të kancerit në botë, në rajonin e Ballkanit, në Shqipëri dhe Kosovë; për përparësitë në këto politika, për nevojën e ndryshimit të menaxhimit të kujdesit për të sëmurët me kancer, për njohjen e faktorëve të riskut dhe për strategjitë e reduktimit të përhapjes së kancerit në vendin tonë. Në përfundim të konferencës u përpilua “Karta e konferencës”, që kishte në fokusin e saj parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të kancerit, si dhe rekomandimet për institucionet politikëbërëse vendimmarrëse, për komunitetin shkencor dhe për të gjitha palët e interesuara, të përfshira në fushën e shërbimeve shëndetësore.

- **Konferenca shkencore:**

- **“Fan Noli – kryeministër” ( 21 qershor 2014)**

Konferenca u organizua nga Akademia e Shkencave në bashkëpunim me Fondacionin “Fan Noli”, kushtuar 90-vjetorit të Revolucionit të Qershorit dhe rolit të F.S. Nolit në zhvillimet demokratike të Shqipërisë së viteve '20-'30 të shekullit që shkoi. Referuesit në konferencë vunë në dukje se ngjarjet e qershorit 1924, ishin një revolucion demokratik për vetë forcat dhe idetë e tij lëvizëse dhe përsa i përket programit të qeverisë, një ngjarje me rëndësi historike që nuk mund të gjykohej thjesht nga rezultatet imediate, por nga pasojat historike që pati, në dritën e relativitetit historik të aksionit politik të forcave demokratike të kohës

- **Konferenca shkencore ndërkombëtare:**

- **“Development of hydrological and hydraulic study of regulation of Shkodra Lake and Buna River water regime”(10 dhjetor 2014)**

Akademia e Shkencave e Shqipërisë organizoi në sallën e Bibliotekës shkencore Konferencën shkencore ndërkombëtare, “Development of hydrological and hydraulic study of regulation of Shkodra Lake and Buna River water regime” në kuadër të përfundimit të Projektit IPA, bashkëpunim i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Malit të Zi, (si partner lider) me ASH. Të dyja akademitë kanë realizuar studimin në bashkëpunim me institucionet e specializuara në fushën e hidrometeorologjisë; kështu, ASHSH ka bashkëpunuar me Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe të Mjedisit (IGJEU) të UPT. Projekti ka si objektiv kryesor studimin hidrologjik, hidraulik dhe hidrogeologjik të sistemit ujqor të liqenit të Shkodrës dhe të lumit Buna, çka është arritur nëpërmjet realizimit të disa veprimtarive shkencore dhe monitoruese. Në këtë konferencë u paraqitën rezultatet shkencore të palës shqiptare.

- **Konferenca shkencore ndërkombëtare:**

**“Chemical, physical and ecotoxicological characterization and analyses of antivegetative biocides and ecological risks on both sides of the Adriatic coasts” (11 dhjetor 2014)**

Konferenca u organizua me rastin e përfundimit të projektit të realizuar në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Dypalësh Itali – Shqipëri (2012–2014). Projekti u zhvillua nga Seksioni i shkencave natyrore dhe teknike i ASHSH në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe “Agenzia Nazionale per le nuove tecnologie, l’energia e sviluppo economico sostenibile” (ENEA) me partnerë Unita’ Tecnica Tecnologie Portici, Laboratorio Chimica Ambientale, Napoli, Italia. Synimi i projektit ishte vlerësimi ekotoksikologjik i biocideve, si dhe i riskut të tyre në mjedise ujore, si pasojë e teknologjive që përdoren në peshkim.

- **Konferenca e 8-të për bimët aromatike mjekësore e vendeve të Europës Juglindore (19-22 maj 2014)**

Shoqata për bimët aromatike mjekësore (BAM) e vendeve të Europës Juglindore (AMAPSEEC) dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës, me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizuan për herë të parë në Shqipëri, konferencën e 8-të për bimët aromatike mjekësore të këtyre vendeve, më 19-22 maj 2014. AMAPSEEC është shoqata e parë rajonale, e cila bashkon specialistët e interesuar për BAM, ose që punojnë në këtë fushë dhe nxit e mbështet shkëmbimin e ideve dhe bashkëpunimin e të gjithë sektorit të BAM në rajonin e Europës Juglindore dhe më gjerë. Së bashku me Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, AMAPSEEC ka ftuar të gjithë të interesuarit për të marrë pjesë në takim e për të shkëmbyer interesat, përvojat dhe ekspertizat. Ekspertët pjesëmarrës vinin nga rreth 40 vende të botës.

- **Referim akademik:**

**“Prodhimi - kthesa drejt rritjes ekonomike” i akad. Anastas Angjeli (30.01.2014)**

Akademia e Shkencave e Shqipërisë me referimin shkencor “Prodhimi - kthesa drejt rritjes së prodhimit” të akad. Anastas Angjeli, fillon organizimin e referimeve shkencore periodike me synimin që çdo anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë të ketë mundësinë të referojë arritjet kryesore shkencore në fushën përkatëse. Thelbi i këtyre referimeve nuk qëndron dhe vetëm në paraqitjen e veprave shkencore - sipas traditës të ashtuquajtura “promovime” -, por në paraqitjen e tematikës së studiuar, në parashtrimin e tezave kryesore të kësaj tematike, në argumentimin e tyre, njëherësh për të nxitur diskutimin akademik dhe të specializuar. Analiza trajtoi këtë problematikë të fundit të viteve ‘80 dhe përfundon në ditët e sotme, duke trajtuar kryesisht

aspektin ekonomik të tranzicionit shqiptar. Në shërbim të këtij aspekti janë trajtuar edhe aspekte të tjera politike, financiare, juridike, sociale dhe kulturore. Pjesë të këtij mendimi shkencor janë shndërruar në politika, akte ligjore dhe nënligjore, të cilat në shumë raste kanë ndikuar në zhvillimet ekonomike dhe sociale të vendit. Referimi u pasua nga diskutime të specialistëve të fushës përkatëse mbi teza të referimit përmes një përmbledhjeje të paranjohur. Vepra u vlerësua si një produkt shkencor bindës, që mund të vihet në shërbim të institucioneve publike dhe jopublike të interesuara.

• **Referim akademik:**

**“Zhvillimi – sfidues i varfërisë” i akad. as Kosta Barjaba (19.03.2014)**

*Çështjet e trajtuara:*

-Diskutime mbi çështjet e varfërisë dhe bashkudhëtares së saj, papunësisë, si barrë që kanë rënduar dhe sot shoqërinë shqiptare, por edhe kanë tejzgjatur periudhën e ashtuquajtur tranzicioni shqiptar.

-Parashtrim i zgjidhjeve jo vetëm si teori, por edhe si praktikë, të cilat duhet të shërbejnë si bazë për orientime dhe vendimmarrje dobiprurëse në shërbim të realiteteve social-ekonomike të vendit.

• **Referim akademik:**

**“Probleme të historisë së letërsisë”, i akad. Floresha Dados (16.05.2014)**

Autorja parashtrori disa teza paraprake rreth problematikës së trajtuar.

Akademikja Dado në referatin e saj e parashtrori këtë si një kërkesë të ditës, edhe për faktin se në tekstet e kaluara, për shkak të kërkesave ideologjike të kohës, nuk ka dalë e plotë pamja e zhvillimit letrar, kanë mbetur jashtë autorë të rëndësishëm dhe ka interpretime të njëanshme. Diskutimet rreth referatit në të cilat morën pjesë studiues si Bashkim Kuçuku, Shaban Sinani, Dhurata Shehri, Kastriot Gjika e të tjerë, u përqendruan në nevojën të hartimit të një vepre akademike për historinë e letërsisë, në vështirësitë e realizimit të këtij projekti që kërkon mbështetjen nga shteti të institucioneve që merren me studimet historiko-letrare.

• **Forumi Publik:**

**“Përparësi të vreshtarisë dhe të verëtarisë në Shqipëri” (26 maj 2014)**

Forumi u organizua nga Akademia e Shkencave, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe u zhvillua më 26 maj 2014, në sallën “Aleks Buda” të ASH. Auditori i interesuar për problemet e vreshtarisë dhe verëtarisë mbizotërohej nga studiues dhe specialistë nga bota akademike dhe institucionet kërkimore, nga dikasteret e interesuara, nga prodhues dhe specialistë të njohur në vreshtarinë dhe verëtarinë shqiptare, drejtues dhe specialistë të shoqatave dhe të organizmave të tjerë të këtyre fushave, por nuk munguan dhe amatorë

të këtyre veprimtarive, shijues të verërave etj. Specialistët shtruan problemet për një hop më cilësor organizues-investues-prodhues, për t'u përballur me tregun e brendshëm dhe me import-eksportin e rrushit dhe të verërave. Gjatë këtij forumi shkencor u përrua "Enciklopedia e vreshtarisë dhe e verëtarisë", si një traktat për vreshtarinë dhe verëtarinë shqiptare me autor prof. dr. Andrea Shundi. Forumi shtroi ndërmjet të tjerave, si domosdoshmëri aktuale ngritjen e Entit shtetëror të vreshtarisë dhe verëtarisë.

- **Simpoziumi X ndërkombëtar:**

- **"Biodiversiteti, ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm për zhvillimin rural" (12 dhjetor 2014)**

Simpoziumi u organizua në mjediset e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në sallën "Aleks Buda" të ASH nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë Krujë dhe Korçë dhe Shoqata "Albagene" në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, Kosovë dhe Universitetin e Tetovës, Maqedoni. Në punimet në dy seksionet e veçanta (Biodiversiteti në bimë dhe në kafshë), u përfshinë rreth 190 kërkues dhe specialistë të fushave të ndryshme të biologjisë, bujqësisë, blegtorisë, ekologjisë etj., kryesisht kërkues të Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe të Korçës, si dhe nga të gjitha trevat shqiptare, Kosova dhe Maqedonia. Qëllimi i simpoziumit u realizua nga paraqitja e rezultateve shkencore: 25 punime mbi biodiversitetin në kafshë dhe 52 punime mbi biodiversitetin në bimë. Referimet e plota të simpoziumit të përgatitura nga autorët si artikuj shkencorë, do të botohen së afërmi në "Proceedings Book" të këtij simpoziumi.

## 2. BOTIMET SHKENCORE

- **POPULLSIA E KOSOVËS** (1060 faqe) nga *akad. Kristaq Prifti*

Një studim i gjerë, punë shumëvjeçare për popullsinë e të gjitha trojeve shqiptare gjatë shek. XIX, fillimi i shek. XX, vitet 1831-1912. Studimi mbështetet në dokumentacionin osman, në turqishten e vjetër, hulumtuar nga autori në arkivat turke si dhe në arkiva të vendeve të Europës e të Ballkanit dhe një bibliografi të gjerë të autorëve turq dhe europianë kushtuar problemeve të demografisë së Perandorisë Osmane në tërësi dhe në vendet e Ballkanit në veçanti. Vepra hedh dritë mbi shtrirjen territoriale të Kosovës, mbi përbërjen etnike përgjithësisht shqiptare të saj, mbi vazhdimësinë e pranisë së shqiptarëve në trojet e tyre amtare si popullsi *anase* (autoktone), evidenton numrin e përgjithshëm të shqiptarëve sipas regjistrimeve të ndryshme osmane, peshën numerike të popullsisë shqiptare dhe raportin e saj me popullsitë dhe grupet etnike që jetojnë në këtë trevë. Vepra do të shërbejë si një

pikë referimi për studime të mëtejshme mbi problemet politike dhe demografike të Kosovës.

- **Thimi Mitko, *Fjalëtore shqip-gërqisht dhe gërqisht-shqip* (778 f.)**

Vepra botohet në suazën e serisë “Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar, seri që pas një ndërprerje të gjatë, rifillon me këtë botim të kryejë misionin e saj të botimit shkencor-akademik të vlerave më të shquara të trashëgimit tonë kulturor. Botimi i kësaj vepre, përgatitur nga prof. Dhori Qiriazhi, me një parathënie nga akad. Jorgo Bullo, përbën një ngjarje të rëndësishme shkencore dhe një rizbulim të Mitkos jo vetëm si folklorist, por dhe si leksikograf. Vepra është rezultat i hulumtimit shumëvjeçar në arkivin e Th. Mitkos, sjellë në Shqipëri 30 vjet më parë. Fjalëtorja e Mitkos krahas fjalorit të Kristoforidhit, është një nga veprat themelore leksikografike të Rilindjes, një monument i shqipes, një vepër që pasqyron e konservon një pasuri të rrezikuar të fondit të leksikut historik të shqipes. Fjalëtorja në fjalë përmban rreth 6000 fjalë-lema, që me vjeljen e brendshme të fjalorit shkon në dyfishin e tyre, po aq sa fjalori i Kristoforidhit, por që mbeti dorëshkrim dhe sheh sot dritën e botimit, pas më shumë se një shekulli, me nismën e Akademisë së Shkencave.

- **SHPIRTI I FJALËS (460 f.)  
studime historiko-letrare nga akad. Jorgo Bullo**

Siç është vlerësuar nga kritika shkencore me studimet e përfshira në këtë libër autori udhëton nëpër shekujt letrarë herë si historian i letërsisë, herë si filolog-tekstolog, herë si kërkues në burime, me një prirje përgjithësuese për proceset e zhvillimit letrar në Shqipëri, nga fillimet e shkrimeve shqipe, në ditët e sotme. Studimet e këtij libri janë punime në prerjen problematike e tematologjike, tipologjike e strukturore, variantistike e filologjike, tekstore e ndërtekstore, me rëndësi jo vetëm për rinjohjen dhe rivlerësimin e autorëve dhe të zhvillimeve në letërsinë shqipe, por që ndihmon dhe për një lexim të ri të saj.

- **Shqiptarët në optikën e diplomacisë austro-hungareze (354 f.)  
dhe Aspekte rreth krijimit dhe zgjidhjes së çështjes shqiptare, vëll I (420 f) nga *akad. as. Marenglen Verli***

Këto botime janë dy vepra historiografike me studime, analiza historike e dokumente me rëndësi për historinë politike të shqiptarëve gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe fillimit të shekullit XX. Ato paraqesin interes të veçantë për analizat dhe tezat e reja që shtrojnë, për mënyrën e trajtimit, por dhe për dokumentacionin që sjellin. Këto dy botime pasurojnë bibliotekën e studimeve për historinë e Shqipërisë në periudhën e Rilindjes dhe të formimit të shtetit shqiptar.

- **Jeta e një historiani** (468 f.) nga **akad. Kristo Frashëri**

Edhe pse mban këtë titull, libri nuk është një autobiografi e zakonshme, por një vepër e jashtëzakonshme me pasurinë dhe mprehtësinë e analizave për ngjarje historike të jetuara. Kjo është një vepër e rrallë në llojin e vet, në radhë të parë si burim të dhënash për historinë e ngjarjeve që kanë vënë vulën në proceset e zhvillimeve historike, politike e kulturore të shoqërisë shqiptare, të shtrirë jo pak, por në katër epoka, gjatë katër regjimeve politike në të cilat ka jetuar historiani, jo si një qytetar indiferent ndaj tyre, por si një vëzhgues i hollë dhe objektiv për ngjarje e figura që kanë ndikuar jo pak në historinë e vendit. Studiues i historisë politike, i historisë social-ekonomike, historian i kulturës, qytetërimeve dhe feve, edhe në këtë libër me kujtimet dhe vlerësimet e tij ai rrok gjithë diapazonin dhe mozaikun e jetës shqiptare, me një vizion të qartë dhe të hapur. Veç vlerave historike dhe dokumentare, libri i prof. Kristo Frashërit ka dhe vlera të veçanta stili, duke mbetur një model për këtë lloj literature aq shpesh të lëvruar sot, por pak të shkruar, për objektivitetin, pasionin e bukurinë e stilit.

- **Aleks Buda – Kujtime 2** (568 f.) përgatitur nga **Tatjana Haxhimihali**

Libri vjen si vëll. II i kujtimeve të prof. Budës botuar disa vite më parë. Ky botim paraqet interes jo vetëm se përmes kujtimeve njohim veprimtarinë e shumanshme të prof. Budës si shkencëtar, veprimtar shoqëror e si njeri, por edhe sepse njohim në mënyrë të veçantë rolin e tij për ngritjen e institucioneve arsimore e shkencore në vend, përfshirë institucionin e Akademisë së Shkencave, jo vetëm si kryetar i parë i saj, por dhe si ideator i projekteve madhore shkencore që ngritën lart prestigjin e albanologjisë shqiptare si shkencë kombëtare. Kujtimet e Aleks Budës në këtë kuptim janë pjesë e historisë së albanologjisë dhe e institucioneve që merren me studimin e historisë, gjuhës dhe kulturës së shqiptarëve dhe kanë gjetur mjaft vlerësim në botën e jashtme shkencore albanologjike.

- **Këngët partizane, trashëgimia shpirtërore e LANÇL** (250 f.) përgatitur dhe pajisur me një studim hyrës nga **akad. Vasil S. Tole**

Këngët partizane, pjesë e trashëgimisë shpirtërore të një epoke që hyri në histori me emrin Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar, të mbledhura në një libër si tekste autentike dhe si partitura muzikore, me këtë botim tekstualisht integral, arkivohen në kujtesën historike të kombit. Ato janë dëshmi e kohës, një artefakt poetik dhe muzikor i saj, pjesë e ndërgjegjes patriotike dhe artistike të brezave që i krijuan dhe të brezave që i trashëguan ato. Ato mund të integrohen fare mirë si pjesë e kulturës europiane të rezistencës antifashiste. Kjo na jep të drejtën e njohjes sonë si faktor në koalicionin antifashist, jo

vetëm përmes rezistencës së armatosur, por edhe përmes një kulture që shprehu shpirtin e kësaj rezistence.

- ***Komunikimi në shoqërinë masive*** (576 f.), studim filozofik-sociologjik nga **akad. Artan Fuga**

Libri është rezultat i një kërkimi të thelluar për komunikimin në shoqërinë postkomuniste, tashmë e hapur përballë sfidave të një shoqërie të hapur, me të cilat shoqëritë e qytetëruara janë ndeshur më herët, me zhvillimin e shpejtë, lëvizjet demografike në Shqipëri të pakontrolluara, lirinë e fesë, me ndryshimin e jetës dhe të pamjeve urbane e rurale, të peizazhit, me tronditjen në mos përmbysjen e vlerave, me ndikimin gati të dhunshëm të politikës, medieve dhe të internetit etj. fenomenet më të përgjithshme që trajtohen në vepër, ilustrohen në raste konkrete, rezultat i një pune hulumtuese e vëzhguese të vëmendshme. Libri është një kontribut teorik dhe praktik për probleme të aktualitetit të sotëm në shoqërinë shqiptare, vështruar nga këndi filozofik e sociologjik.

- ***Rithemelimi i mirëqenies: Zhvillimi, sfidant i varfërisë*** (198 f.), nga **akad. as. Kosta Bajraba**

Libri trajton disa çështje të rëndësishme të sinergjisë midis politikave të zhvillimit dhe politikave për uljen e varfërisë. Pjesa më e madhe e shkrimeve të këtij botimi është mbështetur në materialet e paraqitura në Forumin publik të Akademisë së Shkencave “Zhvillimi- sfidant i varfërisë”, zhvilluar në mars të vitit 2014. Kontributet përfshijnë çështje të tilla si: sinergjia midis politikave të punësimit dhe politikave kundër varfërisë, lidhja midis politikave fiskale dhe politikave sociale, lidhja midis varfërisë dhe pabarazisë, roli dhe kundërshtitë e politikave rishpërndarëse, korrelacioni midis zhvillimeve demografike, urbanizimit dhe migrimit, analizat mikro-ekonometrike të varfërisë, roli i sistemit banker në politikën sociale, kombinimi i politikave ekonomike me logjikën racionale të tregut, kontekstet globale dhe lokale të varfërisë, roli i arsimit në uljen e varfërisë, roli i lirive ekonomike në zhvillimin e vendit dhe uljen e varfërisë etj.

- ***Transnational Networks, Transnational Entrepreneurship and the Role of the State: the Cases of Serbia and Albania*** (186 f.), nga **akad.as Kosta Bajraba**, botuar në gjuhës angleze

Libri trajton disa aspekte të rëndësishme të sinergjisë midis migrimit dhe zhvillimit, rolit të migrimit të punës në lindjen e dukurive të sipërmarrjes dhe edukimin e shprehive sipërmarrëse, ndikimin e rrjeteve transnacionale të sipërmarrjes në zhvillimin ekonomik të rajonit, me fokus të veçantë në Shqipëri dhe Serbi, rishikimin e politikave ekonomike dhe politikave shtetërore për migrimin, sipërmarrjen dhe bashkëpunimin rajonal etj.

- **Journal of Natural and Technical Sciences** (JNTS), revistë shkencore shumëdisiplinore në gjuhën angleze.

Revista ka realizuar botimet e saj vjetore që përfshihen në tre numra (numri 36/1, numri 36/2 dhe 36/3 të vitit 2014) me artikuj shkencorë në disa fusha si në : matematikë, ekonomi-matematikë, fizikë e aplikuar dhe fizikë bërthamore, kimi, kimi ushqimore, ndotje radioaktive e mjedisit të jashtëm (tokë dhe ujë) dhe mjedis i brendshëm, ndotje liqenore nga njeriu, bioteknologji bimore dhe biologji molekulare, biologji, mjekësi, ndotje mikrobiologjike e ujit të lagunave (Nartës), industri e tekstileve, gjeologji, inxhinieri mekanike, inxhinieri ndërtimi; përmbledhje shkencore mbi përdorimin me efikasitet ekonomik dhe mjedisor të mbetjeve të ngurta industriale të ricikluara, si dhe informacione shkencore mbi ngritjen e drejtorisë së gjeologjisë marine, mbi konferencën e bimëve mjekësore dhe aromatike të Shoqatës së Bimëve Mjekësore dhe Aromatike të Europës Juglindore. Revista është pajisur me një numër të ri ISSN-je: 2489-0484 dhe me Global Impact Factor 0.6.

- **Journal of Agriculture of Animal Production Science for the Rural Development (Kërkimi Shkencor në Bujqësi dhe Prodhimin Shtazor për Zhvillimin Rural, JAAPSR)**

Botim i përbashkët i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe i Fondacionit “Shkencë, Teknologji, Shërbim Këshillimor për zhvillimin e Fermës, BLELAL”, realizoi botimin e dy numrave të rinj: numri 1 (17 artikuj, 106 f.) dhe numri 2 (13 artikuj, 86 f.).

- **Shqiptarët në luftën II Botërore** (470 f.), autor **Paskal Milo**.
- **Çështje të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare** (758 f.) , autor **Xhelal Gjeçovi**.
- **Vasil S. Tole**. Truja Takuina, **Muza e parë, rrëfim autobiografik**, Albas, 2014.
- **Frashëri A., Bushati S. Atlasi gjeotermal i Shqipërisë dhe Platforma e shfrytëzimit të nxehtësisë së Tokës**, me grup-autorësh dhe përgatitur për botim nga prof. dr. A. Frashëri dhe akad. prof. dr. S. Bushati, 157 f.
- **Haxhimihali Dh., Vito S. Trajtimi i ujërave të shkarkimeve industriale e urbane**, Klean, Tiranë 2014, 175 f.
- **Malollari I., Manaj H., Dhroso A. Manual i Inxhinierisë Kimike**; Infbotues, Tirana 2014, ISBN: 978-9928-173-05-8, 384 f.
- **Pinguli E., Kamenica M., Negovani K., Gjeta N. Mbrojtja e qytetit të Shkodrës nga përmbytjet**, Tiranë, 197 f.
- **Pinguli E., Pinguli N. Drejtimi që duhet të marrë industria e prodhimit të energjisë elektrike në dekadat e ardhshme në shfrytëzimin e erës në Botë dhe Shqipëri**, Tiranë, 164 f.
- **Thereska N. Teksti i Nefrologjisë** (për studentët dhe specializantët) (Përkthim, në botim).



- **Thereska N., Pasko N., Mumajesi S., Kalo I., Çela M., Nezaj R. Edukimi terapeutik i të sëmurëve me sëmundje renale kronike** (Udhëzues) 2013 -2014.
- **Thereska N., Pasko N., Mumajesi S., Kalo I., Çela M., Nezaj R. Edukimi terapeutik i të sëmurëve me dializë** (Udhëzues) 2013 -2014.
- **Thereska N., Pasko N., Mumajesi S., Kalo I., Çela M., Nezaj R. Trajtimi i anemisë në sëmundjet renale kronike (SRK)** (Udhëzues) 2013 -2014.
- **Thereska N. Të dhënat e sëmundjeve renale (Dializë-Transplant për Shqipërinë, ERA-EDTA - Registry Annual-Report 2012: Qendra Akademike Mjekësore, Departamenti i Informatikës Mjekësore, Amsterdam, 2014.**
- **Vangjeli J. Excursion Flora of Albania.** (përpunim), Shtëpia botuese Koeltz Scientific Publisher, Gjermani, (publikim në muajin mars 2015).

### 3. PROJEKTE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

- Projekti **Mbi veprimtarinë e Këshillit Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe (2014).**

Edhe gjatë vitit 2014 Këshilli Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe ka vazhduar punën sipas programit dhe tematikës së paracaktuar. Gjatë vitit u paraqitën nga grupet e punës dhe u diskutuan në këshill çështje të gjuhës shqipe që kanë të bëjnë me leksikun, me drejtshkrimin dhe me morfologjinë e shqipes standarde.

- **Akad. Ethem Likaj, Morfologjia e shqipes standarde.**

Botim i plotësuar dhe i rindërtuar. Botimi përfaqëson një trajtim të ri të morfologjisë së shqipes standarde; ai parashtron strukturën morfologjike të gjuhës shqipe në një konceptim të ri, ku fjala nuk studiohet vetëm si formë, por, në radhë të parë, si strukturë e segmentuar me të gjitha elementet përbërëse të saj. Projekt i përfunduar dhe bërë gati për botim.

- **Projekti “Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX”, pjesë e projektit të AKTI; akad. Beqir Meta** ka përfunduar pjesën e tij, gjithsej 368 faqe.

• Projekti dyvëllimësh **“Historia e shqiptarëve të shekullit XX”,** me pjesëmarrjen e **akad. as Marenglen Verli,** si hartues i pjesëve të caktuara në këtë projekt të Institutit të Historisë pranë QSA, të financuar nga MASH.

- Projekti në vazhdim **“Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe”,** i **akad. Kolec Topalli.**

Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe po hartohet sipas një projekti të miratuar në vitin 2011 në Këshillin Shkencor të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë të Qendrës së Studimeve Albanologjike. Këtu përfshihen fjalët sipas rendit alfabetik: fjalë të trashëguara, të huazuara, krijime të brendshme, fjalë të reja etj. Ky fjalor mendohet të ketë një vëllim të vetëm me rreth 1800-2000 faqe. Puna për përfundimin e fjalorit vazhdon.

- Projekt në vijim i Ministrisë së Drejtësisë për **“Reformën ligjore”**. **Akad.as Aurela Anastasi** është anëtare e këtij komisioni, për realizimin e këtij projekti.
- Projekti studimor universitar **“Diversiteti kulturor në media”** me drejtues shkencor **akad. Artan Fuga**. (Projekt i ri shkencor).
- **“Onomastikë dhe etnolinguistikë”** punim i **akad. Gjovalin Shkurtaj**. Ky projekt për botimin e këtij libri ka përfunduar, pas përpunimit dhe zgjerimit të tij.
- **“Aplikimi i teknologjive të imazheve satelitore në vlerësimin dhe parashikimin e integruar të fenomeneve gjeodinamike me qëllim zbutjen e pasojave, në zonat urbane dhe turistike të rajonit bregdetar. Programi Kombëtar “Mjedisi dhe Biodiversiteti” (2010-2014)**. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. M. Lamaj, L. Moisiu, A. Avxhi, M. Dardha, M. Jusufati, **akad. prof. dr. S. Bushati**, **akad. prof. dr. N. Frashëri**.
- **“Nanolidhjet e titanit për aplikime biomjekësore”**, në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Shqipëri-Austri me koordinatore të palës shqiptare **akad. as. A. Veveçka** në bashkëpunim me Departamentin e Fizikës, Universiteti i Vienës. Për palën Austriake koordinator është prof. Erhard Schafler.
- Projekt **“Herbari Kombëtar dhe Informatizimi”** në kuadër të hartimit të “Atlasit të Florës së Shqipërisë” në dy vëllime me koordinator **akad. J. Vangjeli**. Qendra Kërkimore e Florës dhe Faunës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, UT.
- Hartimi i monografisë **“Prodhimi cilësor i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve”** ASHSH, FSHN - UT; UBT; QTTB, Vlorë, MBUMK dhe ASHAK (SShN), me koordinatore: **akad. as. E. Kongjika** (ASHSH) dhe **akad. L. Susuri** (ASHAK).
- Projekti **“Mbështetja për asetin e grave në të drejtat e pronësisë përmes informimit, ndërgjegjësimit dhe këshillimit ligjor”**, me pjesëmarrjen e **akad. as. Aurela Anastasi**. Ky projekt po realizohet me mbështetjen financiare dhe teknike të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në Shqipëri (UN women), në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 1012-1016.
- Projekti në vazhdim **“Observatori europian i gazetarisë”**, me drejtues shkencor **akad. Artan Fuga**, mbështetur nga Agjencia e Kërkimit Shkencor të Zvicrës.
- Projekti në vazhdim **“Media shqiptare në tranzicion”**. **Akad. Artan Fuga** është bashkëdrejtues i këtij projekti të Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit të Fakultetit Histori-Filologji, Tiranë dhe Qendrës së trajnimit të gazetarëve të rinj, mbështetur nga Fondacioni “Konrad Adenauer”.
- Projekti **“Development of hydrological and hydraulic study of regulation of Skadar Lake and Bojana River water regime”** – (Zhvillimi i studimit hidrologjik dhe hidraulik i rregullimit të regjimit ujqor të liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna), në kuadër të **Projektit IPA**.

Projekti zhvillohet nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Malit të Zi (partner lider) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë (partner, **akad. G. Beqiraj**, nënkryetar i ASH)). Periudha 2012-2014. Numri i kontratës: 2012/287-023; koordinator për palën shqiptare është **akad. S. Bushati**.

- Projekti **“IDEALIST’ 2014”**, që financohet nga **Programi Kuadër 7 i Komisionit European** me partner në Shqipëri **akad. N. Frashëri** dhe mbështetës **akad. J. Kaçani**.

**Projekti** synon nxitjen e pjesëmarrjes në FP7 nëpërmjet qarkullimit të informacioneve mbi projekt-propozimet dhe mbështetjen e tyre. Në dhjetor 2014 përfundoi projekti për mbështetjen e projekt-propozimeve në FP7. Është marrë pjesë në veprimtaritë e projektit dhe janë qarkulluar informacionet mbi kërkesat për partnerë nga propozues projektesh në fushën e TIK në FP7. (<http://www.ideal-ist.net/>). Projekti drejtohet nga Qendra Aerospaciale në Gjermani.

- Projekti **“KHE-STO (IPA Adriatik)”** për rritjen e njohurive mbi transportin e qëndrueshëm me shfrytëzimin e TIK gjatë krizave mjedisore, me pjesëmarrës **akad. N. Frashëri** (<http://www.khe-sto.info/>) dhe **akad. J. Kaçani**.

Krahas Universitetit Politeknik të Tiranës nga Shqipëria në projekt marin pjesë dhe dy ojç, Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Qendra Kombëtare për Lëvizjen Mjedisore, me koordinator Universitetin “L’Aquila”, Itali.

- Projekti **“FETCH” i Programit European ERASMUS** për mbështetjen e edukimit dhe trajnimit informatik në të ardhmen, me koordinator Universitetin e Ruisë në Bullgari. **Akad. prof. dr. N. Frashëri** është anëtar i grupit të punës të Universitetit Politeknik të Tiranës.

- Projekti **“Materials, Physics and Nanosciences, MP 1103”**, në kuadër të **Programit COST (European Cooperation in Science and Technology)** (2011-2015), financuar nga Komisioni European. Koordinator e palës shqiptare **akad. as. A. Veveçka**.

- Projekti **“Innovative Approaches for Better Utilization of Local Biodiversity in SEE Based on Ethnopharmacology”** (Qasjet inovative për përdorim më të mirë të biodiversitetit lokal në EJT bazuar në Etnofarmakologjinë), **aprovuar nga Komiteti i Programit pjesëmarrës të UNESCO (31 mars 2013 - 31 mars 2014)**.

Operator: Akademia Bullgare e Shkencave - Instituti i Kimisë Organike me Qendër të Fitokimisë për **“Southeast European Network on Phytochemistry and Chemistry of Natural Products for Green and Sustainable Growth” (SEE PhytoChemNet)** (**“Rrjeti i Europës Juglindore për fitokiminë dhe kiminë e produkteve natyrore për rritjen e qëndrueshme dhe të gjelbër”**) (**SEE PhytoChemNet**); Vendet pjesëmarrëse: Shqipëria, Bullgaria, Maqedonia, Serbia. Qëllimi i projektit lidhet me standardizimin, si pjesë më e rëndësishme për kërkuesit që duhet të krahasojnë të dhënat e tyre me rezultatet nga studimet e tjera. Objektivi i projektit: përdorim të mundshëm të *Sideritis* në produktet, bazuar në njohuritë tradicionale, por me njëfarë vlere të

shtuar: çaj bimor në paketë, ekstrakte dhe fitopreparate me veti të standardizuara, etj.

- Projekti **“Curriculum development of Environmental Safety Protection (ESP) and Improving existing safety curriculum by adding ESP aspects”**. Fulbright Senior Specialists Program at University of Tirana, Responsible person: prof. B. Blyukher; contact person at hosting institution **akad. Dh. Haxhimihali**.

- Projekti **“Large-Scale Distributed Scientific Experiments on Shared Substrate**, mbështetur nga National Science Foundation (NSF), Computer and Network Systems, **akad. as. A. Durrësi**.

- Projekti **“Using Lessons from the Disaster in Japan to Develop Communications for Emergency Situations”**, mbështetur nga National Science Foundation (NSF), Computer and Network Systems, **akad. as. A. Durrësi**.

- Projekti **“An Application Delivery Platform for Mobile Apps on Global Clouds”**, mbështetur nga National Science Foundation (NSF), Computer and Network Systems, **akad. as. A. Durrësi**.

- Projekti **“Advanced Mobile and Cloud Computing”**, mbështetur nga Microsoft Research Project Hawaii, **akad. as. A. Durrësi**.

- Projekti **“Development of Electrochemical Peptide Nanosensors for protein and antibody detection – PEPTIDE NANOSENSORS”**. Reference: 294901 Funded by: **European Commission Program: FP7-PEOPLE-2011-IRSES** Period: 01/05/2012 – 30/04/2015 Partners: Fundación Privada Institut Català de Nanotecnologia (ICN); University of Rome Tor Vergata (Italy); University of Kent (UK); Universite Hassan li Mohammadia Casablanca (Morocco); California NanoSystems. Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**

- Projekti **“Nanosystems for early Diagnosis of Neurodegenerative Diseases (NADINE)”**. Reference: CP-IP 246513-2 Funded by: **European Commission**. Official website of the project: <http://www.fp7nadine.eu/> Period: 01/09/2010 – 3/08/2015 Program: FP7 -NMP-2009 4.0-3 Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**

- Projekti **“Sensing toxicants in Marine waters makes sense using biosensors (SMS)”**. Reference: 613844 Funded by: **European Commission Program: FP7-OCEAN 2013.1**. Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**

- Projekti **“Point of Care Diagnostics for rapid and cheap pathogen detection of companion animals – POC4PETS”** Reference: 315653 Funded by: **European Commission Program: PF7-SME-2012-1** Official web site of the project: <http://www.poc4pets-fp7.eu/default.aspx> Period: 01/09/2012 – 31/08/2014. Partners: Fundación Privada Institut Català de Nanotecnologia (ICN); Alma Mater Studiorum – Università di Bologna (Italy); Subcontracted by VETGENOMICS Official web site of the project: <http://www.project-sms.eu/> Period: 01/12/2013– 31/08/2017 Partners: Fundación Privada Institut Català de Nanotecnologia (ICN); Università degli Studi di Roma Tor Vergata (U2), Agenzia Nazionale. Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**

- Projekti. ***“Development of a novel highly sensitive and interference-free endotoxin detection system using new nanobiomaterials and phenomena”***. Reference: BIO2013-49464-EXP; Funded by: **Ministerio de Economía y Competitividad** Period: 01/09/2014 – 31/08/2016 Partners: Fundació Institut Català de Nanociència i Nanotecnologia (ICN2); Universitat Autònoma de Barcelona (UAB) Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**.

- Projekti ***“Nanomaterials for highly on-off electroswitchable recognitions capabilities with outstanding electrobiosensing applications – NANOHEROES”***. Reference: MAT2011-25870 Funded by: **MINECO Program: Plan Nacional de I + D + i** (2008-2011) Period: 01/01/2012 – 31/12/2014 Partners: Fundació Privada Institut Català de Nanotecnologia (ICN) Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**.

- Projekti ***“Nuevas soluciones basadas en printed electronics para la detección de variables físicas y la liberación de compuestos orgánicos”***. Reference: TSI-100101-2013-94 Funded by: **Ministerio de Industria, Energía y Turismo** Period: 2014-2016 Partners: CREACIONES AROMATICAS INDUSTRIALES, S.A.; Fundació Institut Català de Nanociència i Nanotecnologia (ICN2) and D+T Microelectrónica / IMB-CNM (CSIC) as subcontracted. Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**.

- Projekti ***“Smart printed paper: Printed electronics for new paper functionalities”***. Reference: RTC-2014-2619-7 Funded by: **Ministerio de Economía y Competitividad**. Period: 01/02/2014-31/12/2016 Partners: Fundació Institut Català de Nanociència i Nanotecnologia (ICN2); Centre Nacional de Microelectrónica (CNM); JUSMER, S.L. Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**

- Projekti ***“Suport a grups de recerca (SGR) reconeguts per la generalitat de Catalunya (grup consolidat)”***. Reference: 2014 SGR 260; Funded by: **AGAUR (Generalitat de Catalunya)** Period: 01/01/2014-31/12/2016 Partners: Fundació Institut Català de Nanociència i Nanotecnologia (ICN2); Universitat Autònoma de Barcelona (UAB). Drejtues kërkimesh **akad. A. Merkoçi**.

- Projekti ***“Renewable Energy Studies in Western Balkan Countries”*** në kuadrin e **Programit TEMPUS** me pjesëmarrjen e disa institucioneve shkencore të Gjermanisë, Austrisë, Bullgarisë, Slovakisë, Shqipërisë, Malit të Zi e Bosnje-Herzegovinës si edhe disa ndërmarrjeve të prodhimit në sektorin e bujqësisë e industrisë energjetike e fushave simotra nga Shqipëria e Bosnje-Herzegovina. Koordinues: **Universiteti i Hohenheimit**, Gjermani. Anëtar i Steering Committee është edhe **akad. N. Gruda**.

## 1.4. VEPRIMTARI SHKENCORE NË AKADEMINË E SHKENCAVE

- **Përrurimi i botimit të akad. Alfred Uçi, *Estetika Migjeniane* (17.01.2014)**

Vepra e **akademikut Alfred Uçi, *Estetika migjeniane***, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, përbën një kontribut i ri original në studimet migjeniane, një studim monografik gjithëpërfshirës që depërton në aspektet e ndryshme të universit migjenian, nga këndvështrimi historiko-letrar, estetik e filozofik.

